



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА E MAQEDONISË SË

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 96-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon,

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-3985/1 nga 16.08.2023, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent sepse bëhet fjalë për një denoncim anonim nga i cili nuk mund të jepet informacion shtesë për pretendimet e cekura.

Lënda me numër 12-3985/1 nga 16.08.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më 16 gusht 2023, një parashtrues i panjohur ka parashtruar denoncim për gjoja parregullsi në punësim në ///, sipas të cilit është formuar lënda me numër 12-3985/1 e datës 16 gusht 2023. Në kërkesën e dorëzuar thuhet se drejtori i shkollës ///, ka punësuar një person me shkallë dhe lloj arsimimi joadekuat për një pozitë të caktuar por jo të spikatur.

KSHPK-së i kërkohet ta hulumton rastin në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se nuk kishte elemente për veprimin e saj kompetent, për faktin se denoncimi anonim i paraqitur nuk kishte të dhëna të mjaftueshme për të specifikuar se çfarë tregohej, dhe për rrjedhojë nuk kishte mundësi për të dhënë informacion shtesë. , për këtë arsye mori vendim për refuzimin e kërkesës.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

pёrgatiti: P.B
miratoi: G.T anёtar i KSHPK-sё.

**KOMISIONI SHТETЌOR
PЉR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

